

**VENDIM**  
**Nr. 281, datë 8.5.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË  
PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË  
ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT,  
NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA  
INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën “b”, të pikës 1, të kreut I, dhe në pikën 25, të lidhjes nr. 3, fjalët “...Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike...” dhe “...Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike...” zëvendësohen përkatësisht me “...Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike...” dhe “...Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike...”.

b) Në shkronjën “ç”, të pikës 1, të kreut I, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

i. emërtesa “Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve”;

ii. emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar”;

iii. pas emërtesës “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura” shtohet “Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve”.

c) Në pikën 1, të kreut IV, fjalët “... Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve...” zëvendësohen me “...Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve...”.

ç) Lidhja nr. 9/6 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Në lidhjen nr. 12, pas emërtesës “Përgjegjës të degëve të tjera vendore të thesarit” shtohet emërtesa “Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi:

a) për përcaktimet e shkronjave “a”, “b” “c” dhe “d”, të pikës 1, të këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit/transferimit të nëpunësve në detyrë dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit;

b) për përcaktimin e shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij vendimi, fillojnë nga data 1 korrik 2024 dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e politikës për rritjen e pagave të përcaktuara në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 9/6**

**KLASAT E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE (NATYRË TË VEÇANTË PUNE) PËR POZICIONET E PUNËS SË NËPUNËSVE NË AGJENCINË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË CANNABIS-IT**

<b>Pozicioni</b>	<b>Klasa e pagës</b>	<b>Grupi i diplomës</b>	<b>Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lekë/muaj)</b>
Titullar i institucionit.	I-3	1	120 000
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes. Kordinator në varësi të drejtpërdrejtë të titullarit.	II-1	1	110 000
Kordinator me funksione drejtuese në njësitë organizative të përmbajtjes.	II-1	1	100 000
Kordinator në njësitë organizative të përmbajtjes.	II-1	1	90 000
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1	0
Përgjegjës i sektorëve mbështetës.	III-2	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes.	IV-1	1 ose 2	90 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-2	1 ose 2 ose 3	0
	IV-3		0